



# LIDHJE TË SIGURTA, TRANSFORMIM DIGJITAL

Pajisje inteligjente shumëfunksionale  
"imageRUNNER ADVANCE DX"

**Canon**



Canon Europe Ltd.  
All rights reserved. © 2021



Canon Europe Ltd.  
All rights reserved. © 2021



Canon ePFLOW Office  
Outstanding Total Cost of Ownership (TCO) Award

## KATALOGU I

# imageRUNNER ADVANCE DX TRANSFORMONI TË ARDHMEN TUAJ

**Si duket e ardhmja e vendit të punës? Është një pyetje që çdo biznes po e shqyrton ndërsa po kalojmë një transformim të vazhdueshëm drejt mënyrave më fluide të punës.**

Duke parë përpara, do të bëhet gjithnjë e më pak e rëndësishme për organizatat që të vendosin për një vend ku do të qëndrojnë fuqia e tyre punëtore; ekipet do të lëvizin midis vendndodhjeve siç e shohin të arsyeshme.

Në zemër të këtij stili "hibrid" të punës është teknologjia. Çdo organizatë është duke kaluar një rrugëtim transformimi digjital i cili do t'u mundësojë punonjësve të punojnë, të lidhen dhe të bashkëpunojnë kudo që janë.

### Gama bardhezi



iR-ADV DX 8700



iR-ADV DX C257/C357



iR-ADV DX C380



iR-ADV DX 717/617/527



iR-ADV DX 4800

MODELI I FUNDIT



iR-ADV DX 6780i



iR-ADV DX 6800

MODELI I FUNDIT



iR-ADV DX C478

MODELI I FUNDIT



iR-ADV DX C5800

MODELI I FUNDIT

Ndërsa mënyra sesi ne punojmë po ndryshon kaq dukshëm, e njëjta po ndodh edhe me ato që na duhen nga pajisjet tona të printimit dhe të skanimit.

10 vjet më parë nga printeri kërkohej vetëm nxjerrja e kopjeve fizike të dokumenteve. Kjo nevojë nuk është zhdukur, por për t'iu përgjigjur stileve të sotme të punës hibride, printeri ka nevojë për kapacitete të reja për ta bërë një qendër si për printimet ashtu edhe për ciklet e punës digjitale:

Për të mbështetur cikle efikase të punës hibride, pika duhet të jetë jo vetëm vend ku printohet digjitalja, por dhe ku printimi shndërrohet në digjital. Duhet të lidhet pa probleme me aplikacionet tuaja të hapësirës së punës, duke lejuar që dokumentet të lëvizin lehtësisht nëpër ciklet e punës.

Dhe duhet të ofrojë siguri, duke mbrojtur informacionin më delikat të bizneseve tuaja kudo që të ndodhet në ciklin jetik të dokumentit.

Katalogu i imageRUNNER ADVANCE DX i Canon është dizajnuar duke pasur parasysh punën hibride efikase. Duke u mbështetur në platformën e vlerësuar me çmime imageRUNNER ADVANCE të gjeneratës së 3-të, katalogu i pajisjeve inteligjente shumëfunktionale është ndërtuar me teknologjinë më të fundit të regjistrimit dhe të procesimit të dokumenteve, si dhe lidhjeve të avancuara në renë kompjuterike. Produktiv, i sigurt dhe i lidhur, katalogu i imageRUNNER ADVANCE DX ndihmon për të shpënë përpara rrugëtimin tuaj të transformimit digjital duke integruar në mënyrë të përsosur informacionin fizik të printimit me atë digjital.

### Gama me ngjyra



# TRANSFORMIMI I PRODUKTIVITETIT

**Ndërsa organizatat përshtaten ndaj një fuqie punëtore më të shpërndarë, ato po rivlerësojnë mënyrën se si e përdorin zyrën, dhe nga ana tjetër se si i menaxhojnë dokumentet dhe informacionin.**

Shumë organizata që janë duke ndërmarrë një stil pune afatgjatë në distancë do të kenë më pak punonjës në zyrë çdo ditë.

Kur punonjësit janë në terren, ata do të dëshirojnë të punojnë sa më me produktivitet të jetë e mundur. Kështu, kur bëhet fjalë për menaxhimin e dokumenteve, nga printimi i një broshure, te skanimi i një kontrate, atyre u nevojiten pajisje që janë të shpejta, të thjeshta për përdorim dhe mbështesin cikle efikase të dokumenteve.

Pajisjet tona ofrojnë shpejtësinë më të lartë të skanimit dhe të printimit për ta mbajtur biznesin tuaj sa më të qetë të jetë e mundur.



**Pajisjet tona përdorin automatizimin dhe trajnimin kompjuterik për të kursyer kohë të vlefshme për punonjësit.**

Ndërkohë, teknologjia e përparuar e skanimit punon pa ndërprerje me **softuerin tonë uniFLOW Online** për t'i mbajtur punonjësit tuaj produktivë duke minimizuar kohën e shpenzuar për detyra të panevojshme. Punë të tilla si emërtimi, zgjedhja e një vendi ruajtjeje, identifikimet e palëve të treta dhe ruajtja në grupe janë të automatizuara. Pajisjet tona përdorin gjithashtu trajnimin kompjuterik për të mbajtur mend opsionet e preferuara të skanimit, printimit dhe finicionit, duke minimizuar kohën në pajisje dhe duke kursyer kohë të vlefshme për punonjësit sesa të plotësojnë të dhënat e punëve të rëndomta.

Përveç kësaj, **OCR (njohja optike e germave), e mundësuar nga teknologjia IRIS**, është e integruar në të gjitha pajisjet dhe mundëson klasifikimin e dokumenteve dhe nxjerrjen automatike të të dhënave. **Programi Filing Assist**, një veçori që ofrohet me uniFLOW Online, mund kësaj të identifikojë dhe të skedojë automatikisht dokumentet e skanuara.

Detajet e skanimit, si lloji i dokumentit ose kompania, nxirren në pikën e digjitalizimit dhe përdoren për të emërtuar në çast dhe për t'i ruajtur skedarët në vendin e duhur në renë kompjuterike. Programi gjithashtu mund të mësojë të njohë dokumentet e zakonshme të biznesit për të mbështetur regjistrim më të shpejtë automatik herën tjetër.

Informacioni i nxjerrë mund të futet gjithashtu drejtpërdrejt në programin tuaj të ciklit të punës, që do të thotë se punonjësit kalojnë më pak kohë me futjen manuale të të dhënave.

Kjo teknologji jo vetëm që i kursen kohë fuqisë suaj punëtore, por zvogëlon gabimet duke identifikuar të dhëna të gabuara, të pasakta ose të dobëta gjatë regjistrimit. Katalogu ynë është krijuar për të qenë sa më i lehtë për t'u përdorur, me një ndërfaqe dhe përvojë të qëndrueshme përdoruesi, pavarësisht se cilën pajisje po përdorni.

Kjo e bën të lehtë prezantimin e pajisjeve të reja për fuqinë tuaj punëtore të cilët nuk kanë pse të mësojnë funksione të reja. Ndërkohë, thjeshtësia e ndërfaqes do të thotë që ata humbin më pak kohë për të shfletuar nëpër funksione.

Së fundi, katalogu i imageRUNNER ADVANCE DX ndihmon në krijimin e një pune efikase hibride përmes mundësive të lidhjes. Pajisjet lidhen në mënyrë të përsosur me programin tuaj ekzistues të ciklit të punës dhe ofrojnë pajtueshmëri me një sërë platformash publike të resë kompjuterike, duke siguruar që fuqia juaj punëtore të skanojë e printojë nga aplikacione të njohura si Dropbox dhe OneDrive.

Pajisjet gjithashtu ndihmojnë në lidhjen mes punonjësve në terren dhe në distancë, duke e bërë të lehtë digjitalizimin e informacionit, që do të thotë se punonjësit mund të hyjnë në mënyrë efikase të dokumentet që u nevojiten nga kudo. Katalogu është i pajtueshëm me aplikacionin **Canon PRINT Business** dhe aplikacionin **uniFLOW Online**, që ju lejon ta përdorni pajisjen në distancë dhe të zgjidhni funksione printimi e regjistrimi pa e prekur. Kjo e bën të lehtë për punonjësit të printojnë dhe skanojnë nga çdo pajisje, pa qenë fizikisht pranë saj.



# TRANSFORMIM I SIGURISË DHE I PAJTUESHMËRISË

**Veprimi në ambiente të reja pune sjell një grup të ri shqetësimesh mbi sigurinë, veçanërisht pasi të dhënat do të rrjedhin në vende dhe pajisje jashtë rrjetit VPN.**

Si një pajisje e lidhur, printeri me bazë reje kompjuterike duhet të ofrojë mbrojtje të fuqishme për të siguruar që informacioni të mos bjerë në duar të gabuara.

Katalogu i "imageRUNNER ADVANCE DX" përfaqëson zgjidhjet më të fundit në regjistrimin e sigurt përmes pajisjeve, programeve dhe shërbimeve të "Canon".

Gama e tij robuste e funksioneve të sigurisë ndihmon në sigurimin e konfidencialitetit, hyrjes dhe ofrimit të informacionit tuaj përgjatë gjithë ciklit të tij jetik, pa penguar produktivitetin.

Pajtueshmëria me legjisllacionin në zhvillim, duke përfshirë GDPR, po bëhet gjithnjë e më shumë një përparësi e biznesit.

Katalogu dhe shërbimet e tij i përgjigjen nevojës për siguri fizike dhe digjitale, pa ndikuar në aftësinë e punonjësve për të hyrë tek të dhënat, informacioni dhe dokumentet që kërkojnë për të bërë punën e tyre.

Kjo do të thotë një platformë të sigurt që në projektim, të plotë me autentikim identiteti dhe komanda hyrjeje, shërbime të sigurta të reve kompjuterike publike dhe siguri të optimizuar të dokumenteve, duke maksimizuar stabilitetin e rregulloreve të sigurimit të pajisjeve dhe duke minimizuar rrezikun nga humbja e të dhënave.

Katalogu i imageRUNNER ADVANCE DX është plotësisht i mbrojtur nga një gamë më e gjerë sulmesh, nga sistemi i verifikimit në ndezje, deri të ndërhyrjet në firmuer dhe bllokimi i ekzekutimit të ndonjë programi të paautorizuar. Kjo e fundit sigurohet nga ofruesi kryesor i teknologjisë së sigurisë kibernetike Trellix, me programin e tyre **McAfee Embedded Control Software**. Kombinimi i këtyre funksioneve të sigurisë u pengon hakerëve të mundshëm anashkalimin e mekanizmave të sigurisë të katalogut të pajisjeve.

Të dhënat e Syslog ofrojnë gjithashtu informacion sigurie në kohë reale, rreth pajisjes, që mund të analizohen nga një zgjidhje e përshtatshme pale të tretë duke shfrytëzuar standardet e njohura të sektorit dhe përmirëson integrimin e katalogut me çfarëdo **zgjidhjeje informacioni sigurie dhe menaxhimi rastesh (SIEM)**. Autentikimi i identifikimit të përdoruesve nëpër pajisje bën që edhe punët e dërguara nga celularët të mund të mbahen dhe printohen në mënyrë të sigurt me uniFLOW Online

- duke mbrojtur konfidencialitetin. Për të ndihmuar parandalimin e shpërndarjes së paautorizuar të informacionit delikat, funksione të ndryshme të pajisjes mund të çaktivizohen për përdorues individualë, ndërsa njoftimet pamore dhe zanore "Original Reminder" ju sinjalizojnë nëse në pajisje lihen origjinale të skanuara me informacion delikat.

Printimi nga vizitorët mundëson gjithashtu printim portativ të atypëratyshëm pa qenë nevoja për të hyrë në rrjetin e kompanisë suaj. Me "uniFLOW Online Express" të instaluar si standard, mund të shtoni edhe më shumë kontroll duke kaluar në zgjidhjen "uniFLOW Online" ose versionin e plotë të "uniFLOW".

**Një gamë robuste e funksioneve të sigurisë ndihmon në sigurimin e konfidencialitetit, hyrjes dhe ofrimit të informacionit tuaj përgjatë ciklit të tij jetik.**

#### Funksionet e mëtejshme standarde për imageRUNNER ADVANCE DX përfshijnë:



"HDD and SSD Erase" fshin imazhet e mbetura pas çdo detyre.



"HDD and SSD Format" heq e mbishkruan të gjitha të dhënat në njësinë e diskut në fund të ciklit jetik.



"HDD and SSD Data Encryption" ndihmon në mbrojtjen e informacionit edhe pas heqjes së njësisë së diskut dhe tani vjen me validim për FIPS 140-2 në modele të zgjedhura.



SMB 3.1.1 (mbështetet në modele të zgjedhura) ofron enkriptim të sigurt.



Printim dhe skanim i enkriptuar dhe "Secure Watermark"



Rrjet dysh.



TPM 2.0 për teknologji më të fortë enkriptimi.





# TRANSFORMIMI I QËNDRUESHMËRISË

**Qëndrueshmëria nuk ka qenë kurrë më lart se tani në planin e korporatave apo të punonjësve. Ne besojmë me pasion në përfitimet që "Canon" dhe njerëzit, produktet dhe shërbimet e saj mund të sjellin për klientët tanë dhe shoqërinë në përgjithësi.**

Ndaj dhe ne punojmë sipas filozofisë Kyosei - një fjalë japoneze që do të thotë "të jetojmë dhe të punojmë së bashku për të mirën e përbashkët". "E mira e përbashkët" përcaktohet nga "Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm" (SDG) të OKB-së të cilat sigurojnë një kuadër për Canon për të menaxhuar ndikimet e tij sociale dhe mjedisore."

**Seria e fundit e imageRUNNER  
ADVANCE C5800 prodhon deri në  
18% më pak CO2 dhe peshon 20%  
më pak se paraardhësja.**



iR ADV DX C5800



Katalogu i imageRUNNER ADVANCE DX ngrihet mbi bazën e këtyre vlerave. Seria e fundit **imageRUNNER ADVANCE C5800 Series** prodhon deri në 18% më pak CO2 në të gjithë ciklin jetik të produktit, ndërsa modelimi i gamës minimizon përdorimin e materialit deri në 20% më pak se paraardhësja, imageRUNNER ADVANCE DX 5700 Series.

Ndërkohë, teknologjia e saj inteligjente optimizon cilësimet, duke minimizuar mbetjet, energjinë dhe konsumin e letrës.

Për shembull, programi i pajisjes mund të heqë faqet bosh, ndërsa fuqia e përmirësuar e përpunimit dhe aftësitë e shqyrtimit paraprak të serisë zvogëlojnë nevojën për të printuar e riprintuar dokumentet thelbësore.

Konsumi i korrentit mbahet gjithashtu sa më ulët të jetë e mundur, falë mënyrave të avancuara të fjetjes, që do të thotë se nuk ka përdorim të tepërt të energjisë. Përmirësimet me shkrirjen e tonerit në edicionin tonë të fundit për katalogun, imageRUNNER ADVANCE DX C5800 Series, kanë

rezultuar në një ulje prej 15% të vlerës së TEC krahasuar me modelet e mëparshme me të njëjtën shpejtësi printimi. Kjo arrin një shpejtësi më të lartë printimi (70 ppm) me të njëjtin konsum të energjisë si modeli i mëparshëm 60 ppm.

Ciklet e avancuara të punës dhe statistikave e ofruara përgjatë platformës "imageRUNNER ADVANCE DX" bëjnë që organizata të mund ta optimizojë printimin e përdorur me kalimin e kohës, duke siguruar që funksioni të nxjerrë vlerë maksimale.

Këto funksione ndihmojnë katalogun e Canon të mbështesë teknologjinë digjitale në ruajtjen e vlerave të organizatave moderne: duke ofruar e mbështetur funksionim maksimal me impakt pozitiv mjedisor në ambientin e punës.

Përmes novacionit të vazhdueshëm, ne kërkojmë të zvogëlojmë impaktin mjedisor të produkteve tona gjatë gjithë ciklit të tyre jetik. Si partneri juaj, këto ndryshime ju ndihmojnë kështu të përmbushni synimet dhe vlerat e qëndrueshmërisë së organizatës suaj.



# INTEGRIM DIGJITAL

**Ju duhet një zgjidhje që është mjaftueshëm praktike për t'ju mbështetur strategjinë e resë kompjuterike dhe softuerët e vjetër. Një që punon tani, si dhe me rrugëtimin tuaj digjital.**

Ndaj dhe katalogu i "imageRUNNER ADVANCE DX" është tërësisht ndërveprues me shërbime kryesuese digjitale, si dhe me zgjidhje të mëtejshme të resë kompjuterike të "Canon". "uniFLOW Online Express" vjen i integruar dhe gati për përdorim, duke shtuar funksione të integruara sigurie për të parandaluar përdorimin e paautorizuar falë autentikimit të pajisjeve, autentikimit dyhapësh dhe aftësive për kufizimin e funksioneve për pajisjet.

Statistikat e avancuara dhe menaxhimi i katalogut vijnë gjithashtu si standard. Duke u përshkallëzuar sipas kërkesës suaj, pajisjet mund të modernizohen gjithashtu me lehtësi në "uniFLOW Online" kur t'ju nevojiten më shumë lidhje me renë kompjuterike dhe funksione të mëtejshme sigurie e raportimi.

Aftësitë e mëtejshme të resë kompjuterike përfshijnë **Canon's Cloud Workspace Collaboration Services - Process Automation (CWC-PA)**, mundësinë e lehtë, inteligjente e të pajtueshme për administrimin e proceseve e të dokumenteve kritike të kompanisë drejtpërdrejt nga pajisja e Canon, pa qenë nevoja për zgjidhje komplekse nga IT. "Cloud Workspace Collaboration Services - Process

Automation" është pjesë e **Canon's Digital Transformation Services (DTS)**, të cilat bashkojnë harduerin dhe softuerin tonë kryesor në një ekosistem të teknologjisë së integruar, të krijuar për të mbështetur rrugëtimin tuaj të transformimit.

Kjo ofertë kombinon softuerin e zgjidhjeve për shërbime printimi të menaxhuar dhe bashkëpunimi në ambientin e punës, e dyta prej të cilave përfshin CWC-PA. Duke punuar më së miri me teknologjitë e gjera të Canon të harduerit dhe të softuerit të lidhur me renë kompjuterike, CWC-PA u mundëson bizneseve të transformojnë digjitalisht menaxhimin e përmbajtjes përmes një platforme SaaS plotësisht të mbështetur në renë kompjuterike.

Integrimi me platformat e ruajtjes në renë kompjuterike, duke përfshirë Box, Evernote, Dropbox dhe OneDrive, e transformon në çast regjistrimin e të dhënave.

Ndërkohë, automatizimi i rrjedhës së punës përmes resë kompjuterike me aplikacione biznesi, duke përfshirë "Therefore" ose "Concur", sigurojnë që ciklet e përparura të punës të përshtaten më së miri në proceset ekzistuese.


**Integrimi me platformat e ruajtjes në renë kompjuterike, duke përfshirë Box, Evernote, Dropbox dhe OneDrive, e transformon në çast regjistrimin e të dhënave.**



# SHËRBIMET E TRANSFORMIMIT DIGJITAL TË CANON

Nxisioni transformimin tuaj digjital, pavarësisht se ku punoni, me pajisjet tona të kombinuara dhe shërbimet e menaxhimit të informacionit, si dhe zgjidhjet e krijuara për të integruar më së miri letrën dhe digjitalen.

Ofruar përmes resë kompjuterike, në vend ose në ambiente hibride, shërbimet tona të transformimit digjital që ndërthurin produkte, shërbime dhe zgjidhje të fjalës së fundit të teknologjisë, ju ndihmojnë të arrini produktivitet, bashkëpunim, siguri, pajtueshmëri dhe objektiva të përmirësuara qëndrueshmërie.



Skema e mësipërme tregon se si elementet e ekosistemit tonë teknologjik punojnë së bashku, përfshirë shërbimet tona të printimit të menaxhuar, zgjidhjet e bashkëpunimit në ambientin e punës dhe pajisjet tona që mbështesin retë kompjuterike.





# PSE "CANON"

**Canon është imazheri. Ne e përdorim këtë imazheri për të sjellë ndryshim dhe për të mundësuar ndryshimin.**

Për klientët tanë teksa ndërmarrin transformimin digjital dhe punojnë me mënyra të reja.

Për ndryshime më të gjera shoqërore me fokusin tonë të vazhdueshëm mbi qëndrueshmërinë si pjesë të trashëgimisë dhe kulturës sonë korporative.

Së fundi ne po ndryshojmë teksta investojmë në tregje, produkte dhe teknologji të reja, kështu që jemi këtu në rang afatgjatë për të mirën e të gjithëve; klientëve tanë, njerëzve tanë dhe shoqërisë më të gjerë.

**Canon është ngritur mbi 4 shtylla kryesore:**



**Risia** - Një histori e gjatë e risive imazherike që ofron teknologji të fjalës së fundit për mbi 80 vjet. Sjellim të parët risitë në sektor dhe me përkushtim të fortë ndaj zhvillimeve të ardhshme në teknologji.



**Mbështetje** - Një katalog i larmishëm shërbimesh për të siguruar cilësi të lartë, duke rezultuar në kënaqësinë e klientit. Ekspertiza e brendshme që punon drejt rritjes së efikasitetit dhe e përkushtuar ndaj çlirimit të potencialit për klientët tanë.




**Siguria** - Zgjidhjet dhe shërbimet e Canon ndihmojnë në sigurimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave delikate, qoftë në format letre apo digjital përgjatë ciklit jetik të dokumenteve. Të sigurta që në modelim, zgjidhjet dhe shërbimet ndërtohen duke pasur parasysh sigurinë.



**Qëndrueshmëria** - Canon i ka njëzuar praktikatat e saj të qëndrueshmërisë me "Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm" (SDG) të OKB-së, si p.sh. zotimet për të zvogëluar emetimet e CO2 në të gjithë ciklin jetik të produkteve duke zvogëluar paketimin dhe duke konsoliduar qendrat e shpërndarjes.

**Të gjithë këta elementë së bashku e bëjnë Canon partnerin e duhur për ju.**



Kontakti **tani** me  
përfaqësuesin tuaj lokal  
të shitjeve të Canon



Specifikime më të  
hollësishme për serinë  
mund të gjeni **këtu**

**Canon Inc.**  
Canon.com

**Canon Europe**  
canon-europe.com

Albanian edition  
© Canon Europa N.V., 2022

**Canon Europe Ltd**  
The Bower,  
4 Roundwood Avenue,  
Stockley Park,  
Uxbridge,  
Middlesex  
UB11 1AF  
Mbretëri e Bashkuar

**Canon**

---